



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORË**

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

FSHMN

Ref. nr. 5554

Prishtinë, Dt. 25/11/2024

**RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT**  
**TE DIPLOMES MASTER**

|                                                            |                                                                                                                                                                                                     |
|------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| FAKULTETI                                                  | FSHMN                                                                                                                                                                                               |
| Departamenti/ Programi                                     | Gjeografi/Gjeografi                                                                                                                                                                                 |
| Projekt-propozimi                                          | Ndikimi i qarkullimeve turistike në cilësinë e jetës së njerëzve<br>Rast studimi: komuna e Shtimes (The impact of touristic movements on people's quality of life. Case study: Shtime municipality) |
| Kandidati                                                  | Besarta REXHEPI                                                                                                                                                                                     |
| Mentori                                                    | Prof. Ass. Dr. Fitim HUMOLLI                                                                                                                                                                        |
| Aprovimi i projekt propozimit<br>në Këshillin e Fakultetit | Datë: 26.12.2023<br>Vendimi nr.: 7914                                                                                                                                                               |

Pas punës fillestare, konsultative me udhëheqësin shkencor të temës master dhe vazhdimit të studimeve në terren të kandidates, si dhe bazuar në kërkesën e kandidates Besarta Rexhepi të datës 22.11.2024 me nr. 5466, paraqesim këtë raport.

**RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT**

Tema me titull “**Ndikimi i qarkullimeve turistike në cilësinë e jetës së njerëzve. Rast studimi: komuna e Shtimes**” e kandidates Besarta Rexhepi përbën studim të veçantë në gjeografinë humane përkatësisht në studimet gjeografiko turistike. E ndërlidhur fuqishëm me aspektet e kualitetit të jetës, tema merr edhe karakter psikologjik nëpërmjet së cilës pasuron interdisciplinaritetin e mirëpritur studimor. E tillë, në format dhe në shtrirje, tema vërtet merr kuptimin e një trajtese tërësisht të munguar dhe mjaftë të nevojshme.

Tema trajton problematike studimore mjaft specifike. E analizuar mirë dhe me kujdes,

mentorë i temës së bashku me kandidaten kanë përzgjedhur komunën e Shtimes si zonë studimi. Kjo duket mirë e menduar dhe mirë e trajtuar. Komuna e Shtimes përbën një komunë qendrore ne vend dhe për nga popullsia dhe sipërfaqja është e përafërt më mjaft të tilla në Kosovë. Rezultatet e saj mund të përfaqësojnë apriori, në mos saktësishst së paku orientimet kryesore të ndikimeve të qarkullimeve turistike në kualitetin e jetës. Kjo kur (siç u theksua sipër), tema përbënë sferë studimi në ndërlidhje me impakte shëndetësore dhe mirëqenie multidimensionale, që në studimet gjeografike dhe ato turistiko-psikologjike, nuk janë hasur në Republikën e Kosovës.

Të bazuar në metoda empirike me metodologji sasiore të realizuara nëpërmjet një numri të pranueshëm të anketave siç është evidentuar në seksionin e Metodologjisë, studimi i sjell nëpërmjet këtij punimi, siguron besueshmëri në rezultatet e dala.

I cilësuar si “laborator gjeografik”, hapësira dhe territori gjithnjë kanë pas vëmendje të veçantë në studimet gjeografike jo vetëm natyrore. Studimi i zj. Rexhepi sjell rezultate konkrete dhe dëshmon qartazi se aplikimi i metodologjisë sonë rezultoi me të dhëna interesante dhe mjaft të nevojshme jo vetëm për komunitetin shkencor por edhe për hartuesit e pakove turistike, për operatorët ekonomik, për familjen dhe për shoqërinë mbarë. Kjo për arsyen se mirëqenia shëndetësore, sociale, ekonomike, qetësia shpirtërore dhe shëndeti mental duhet trajtuar krujiale për familjen dhe shoqërinë shqiptare.

Gjatë analizimit të objektivave të studimit, rezultateve, analizës në seksionin e Diskutimeve dhe përfundimit, vërehet qartazi se kandidatja, zj. Rexhepi e ka mbajtur të orientuar mirë studimin. Kështu duken qartë kontributet, mirë të ndërlidhur me komponentët për të cilat u dëshmua se turizmi ndikon, si: psikologjike dhe fizike, pasurimin kulturor, forcimin e lidhjeve sociale dhe ofrimin e mundësive për aktivitete në natyrë.

Për këto arsyen, një nismë e tillë studimore, tërësisht joshteruese është e pëlqyer dhe kurajuese për vijimin e studimeve tjera.

Kandidatja i ka qëndruar besnik formatit të punimit, sipas rregullores aktuale të studimeve master. Dorëshkrimi ka pasqyruar metodologji adekuate për natyrën e studimit, ndërsa figurat, tabelat dhe veçmas grafikët vetëm sa e kanë plotësuar punimin e studimit në fjalë.

## PROPOZIM

Punimi i Diplomës më titull “**Ndikimi i qarkullimeve turistike në cilësinë e jetës së njerëzve.**

**Rast studimi: komuna e Shtimes**” e kandidates Besarta Rexhepi, paraqet një kontribut të çmuar në studimet gjeografike në përgjithësi dhe gjeografiko-turistike në veçanti. Mbështetur në vlerësimin e punimit të kandidates, një pjesë e të cilave janë shënuar sipëri, komisioni profesional/shkencor vlerëson se punimi i plotëson të gjitha kushtet formale, juridike dhe profesionale-shkencore për mbrojtje publike.

Prishtinë: 25.11.2024

Komisioni:

1.

Prof. Dr. Florim Isufi - Kryetar

2.

Prof. Ass. Dr. Fitim Humolli – anëtar (mentor)

3.

Prof. Asoc. Dr. Shpejtim Bulliqi - anëtar